

A NORMATIVE LEGISLATION AND ETHICS IN E-BUSINESS

Redon Koleci

“Vasil Levski” National Military University, Veliko Tarnovo, Bulgaria, redon_koleci@hotmail.com

Abstract: All business activities, from the establishment of the organization through the sale of the product to consumers, are governed by law. Laws affecting business are derived from a variety of sources, including customs, court decisions, and legislation. Contracts, agency and consumer protection are three key areas that regulate the day-to-day operation of businesses. The relationship between businesses and their clients is governed by a variety of laws, many of which are derived from the statute. In addition to the protection afforded to consumers by law, many organizations also operate by accepted codes of conduct. Commercial businesses consist of a range of organizations with similar legal structure. These legal structures help not only in the ownership and control of the enterprise, but also in other aspects of their operations, including objectives, access to finance, external links and obligations.

Human rights law and ethics aspires to analyze and clarify the concepts of moral and legal rights, as well as to contribute to the resolution of the human rights conflict. Every easy issue focuses on a contemporary dilemma that raises great moral and legal questions. Each such dilemma has been dealt with using an interdisciplinary approach to human rights, an approach which seeks to establish associations between legal deposits and their underlying philosophical thinking.

The law is backed by the power of the state to coerce and punish. Ethics are principles of behavior and culture that have no obligation to the state. Laws will be ethical behavior in society. According to this theory, breaking the law is inherently unethical. 'Legal' and 'Ethical' are often used and inspired in the same sentence. These two concepts are mutually exclusive. They often clash and work with each other. Both words are often used in the same context in terms of issues and social situations. Even " Legal " and " Ethical " can apply to almost any situation, private or public, even in the field of professions.

In the geographical areas closest to us, some important activities are underway in the EU countries with regard to the legal regulation of certain matters by electronic business. Thus, in December 1999, the Council of Ministers of Economy adopted a regulation regulating Internet work. One of the key decisions is that the enterprise should not require any special permission to offer its goods or services online, but should present the basic information about itself and its offer. It is therefore worked according to the rules of the country of origin of the provider, unless otherwise agreed.

It follows from the above that each e-business participant must know his or her own entrepreneurial rights, and if he or she works in a foreign country, then the rules of the country from which the other participant comes are also evident. The connection with the legal framework in the field of electronic business on a global scale can be characterized as unfinished and problematic.

Keywords: Product, organization, law, ethics, businesses and rules.

NORMATIVA LIGJORE DHE ETIKA NË E-BIZNES

Redon Koleci

“Vasil Levski” National Military University, Veliko Tarnovo, Bulgaria, redon_koleci@hotmail.com

Abstrakt: Të gjitha aktivitetet e biznesit, nga themelimi i organizatës përmes shitjes së produktit për konsumatorët, janë të ndikuara nga ligji. Ligjet që ndikojnë në biznes rrjedhin nga burime të ndryshme, duke përfshirë zakonet, vendimin e gjykatave dhe legjislacionin. Kontratat, agjencia dhe mbrojtja e konsumatorit janë tre fusha kryesore që rregullojnë punën e përditshme të bizneseve. Marrëdhënia mes bizneseve dhe klientëve të tyre është e qeverisur nga një shumëllojshmeri e ligjeve, shumë prej të cilave rrjedhin nga statuti. Përveç mbrojtjes së parashikuar për konsumatorët me anë të ligjit, shumë organizata gjithashtu veprojnë nga kodet e pranuar të sjelljes. Bizneset tregtare përbëhen prej një varg organizatash me strukturë ligjore të ngjajshme. Këto struktura ligjore ndihmojnë jo vetëm në pronësinë dhe në kontrollin e ndërmarrjes, po gjithashtu edhe në aspekte tjera të operacioneve të tyre, përfshirë objektivat, qasjen në financim, lidhjet e jashtme dhe obligimet.

Ligji dhe etika e të drejtave të njeriut aspiron për të analizuar dhe sqaruar konceptet e të drejtave morale dhe ligjore, si dhe të kontribuojë në zgjedhjen e konfliktit të të drejtave të njeriut. Çdo çështje e lehtë fokusohet në një dilemë bashkohore që ngre pyetje të medha morale dhe ligjore. Çdo dilemë e tillë është shqyrtuar duke përdorur një qasje ndërdisiplinore për të drejtat e njeriut, një qasje e cila përpiket të krijojë shoqata mes depozitave ligjore dhe të menduarit filozofik themëlor të tyre.

Ligji është i mbështetur nga fuqia e shtetit për të detyruar dhe për të ndëshkuar. Etikë janë parime të sjelljes e të kulturës të cilat nuk kanë asnjë detyrim të përfshirë ndaj shtetit. Ligjet do të jenë sjellja etike në shoqëri. Sipas kësaj teorie, duke thyer ligjin është e natyrshme joetike. "Ligjore" dhe "Etike" janë përdorur dhe frymëzuar shpesh në të njëjtën fjalë. Keto dy koncepte janë reciprokisht ekskluzive e njëri-tjetri. Ata shpesh bien ndesh edhe punojnë me njëri-tjetrin. Te dyja fjalët janë përdorur shpesh në të njëjtin kontekst në drejtim të çështjeve dhe në situatat sociale. Edhe "Ligjore" edhe "Etike" mund të aplikohet pothuajse në çdo situatë, private ose publike, madje edhe në fushën e profesioneve.

Në hapsirat gjeografike më të afërta me neve, në hapësirat e shteteve të BE-së janë në rrjedhë të disa aktivitete të rëndësishme që kanë të bëjnë me rregullimin juridik të disa çështjeve nga biznesi elektronik. Kështu që Këshilli i Ministrave të Ekonomisë në dhjetor të vitit 1999 ka miratuar rregulloren me të cilën rregullohet puna përmes internetit. Njeri nga vendimet kryesore është ajo që ndërmarrsi nuk duhet të kërkojë kurrfarë leje të veçantë që mallin apo shërbimet e veta ti ofrojë në internet, por duhet që të paraqesin shënimet themelore për veten dhe ofertën e tij. Punohet pra, sipas rregullave të atij shteti prej të cilit e ka prejardhjen ofruesi, nëse pjesëmarrësit në punë nuk mirren vesh ndryshe. Nga ajo që u përmend më lartë rrjedh se secili pjesëmarrës në biznesin elektronik duhet ti njoh pikësepari, të drejtat e veta ndërmarrëse, ndërsa nëse punon në shtetet e jashtme, atëherë edhe rregullat e shtetit prej nga vë pjesëmarrësi tjetër. Është e dukshme se situata në lidhje me rregullativën juridike në hapsirën e biznesit elektronik në përmasat botërore mund të karakterizohet si e papërfunduar dhe problematike.

Fjalët kyçe: Produkti, organizata, ligji, etika, bizneset dhe rregullat.

1. HYRJE

Pasiguria e bizneseve të cilët i frikësohen konkurrencës dhe të ardhmes, ndjeshmëria e tyre si të pasigurtë dhe të cilët konkurrenca mund t'i cenojë shumë lehtë, frika nga humbja njerëzisë të tërheqë drejt një afarizmi hazard dhe të kërcënueshëm për të tjerët në konkurrencën e tregut, duke i thyer rregullat e kësaj konkurrence me format më të ndryshme: duke prodhuar prodhime dhe shërbime jocilësore nga ato që i proklamojnë, duke mashtruar, duke ofruar dhe marrë mito për përfitime për biznesin e tyre, shkurt duke shkelur ligjet e ekonomisë së tregut dhe të vepruarit pa moral dhe të bërit e biznesit në mënyrë jo morale/jo etike. Sigurisht se ekziston kjo shtresë e njerëzve në biznes duke qenë qenë të bindur se gjërat mund të bëhen shpejtë dhe jashtë rregullave të cilat i ka vënë ekonomia e tregut. Kjo është tendenca e përfitimeve pa meritë dhe dëmtimi i konkurrencës dhe shoqërisë. Këto janë kërkesa të interesit të cilat të cilat paraqiten si të pamëshirshme. Mirëpo, rrethina institucionale, me ndërtimin e infrastrukturës legjislativë, duhet ta pengojë këtë dukuri në fazën fillestare. Pra, këto ligje duhet të ndërtojnë një kulturë me interesa të ekuilibruara të të gjitha palëve. Këta njerëz në biznes paraqesin njerëzit që njihen dhe quhen njerëz ose personalitete të papërbajtur iluzorë dhe mashtrues ose njerëz që nuk i njohin aftësitë e veta dhe sfidat e rrethinës.

2. ETIKA DHE LIGJI

Fjala etikë buron nga shprehja greke *ethos/ethikos*, që ka domethënien e traditës, dokeve dhe shprehive. Etika paraqet një degë të fillozofisë që merret me vlerat themelore të marrëdhënieve ndërnjerëzore, që studion cilësinë dhe bazën e veprave apo sjelljeve të cilat nga këndi i moralit janë të mira apo të këqija, të qëlluara apo të shëmtuara. Fushat kryesore të studimit të etikës mund të ndahen në katër zona operative:

- ✚ Meta-etika, në lidhje me kuptimin teorik dhe referencën e propozimeve morale.
- ✚ Etika normative rreth mjeteve praktike të përcaktimit të një kursi moral të veprimit.
- ✚ Etika përshkruese e njohur edhe si etika krahasuese, është studimi i besimeve të njerëzve rreth moralit.
- ✚ Etika e aplikuar rreth asaj se si rezultatet morale mund të arrihen në situata të veçanta.

Ligji është një sistem rregullash dhe normash shoqërore që njerëzit duhet të ndjekin në një shoqëri apo vend. Ligjet vendosen dhe zbatohen nga institucionet dhe organet ligjore përkatëse të shoqërisë. Ligji është marrëveshje (dukuri e rregullt) e përcaktuar me disa fjalë nga një bashkësi njerëzish apo njerëzimit. Ligji i nënshtrohet të gjithë pjesëmarrësit që direkt apo indirekt kanë marrë pjesë në formulimin e tij.

3. RREGULLATIVA JURIDIKE NDËRKOMBËTARE NE FUSHËN E-BIZNESIT

Ndihmë e madhe mund të japin informatat mbi ligjet e problematikës juridike të cilat mund të gjinden në Web adresat e caktuara. Është interesante faqja Internet Law & Policy Forum, në të cilën gjenden interpretime të shumta rregullative nacionale dhe ndërkombëtare që janë më rëndësi për biznesin elektronik. Adresa e kësaj faqeje është www.ilpf.org. Përfundimisht njëra ndër web faqet më të mira në segmentin e të drejtës së tregtisë elektronike në internet është ajo e kompanisë The Nolo Press Self-Help Law Center. Këtu ofrohen një enciklopedi e vërtetë e nevojave specifike të ndërmarrësve të vëgjël, mund të gjindet lehtë në adresën e thjeshtë që mbahet lehtë në mendë www.nolo.com

Etika në çdo lloj biznesi, qofshin ato tradicionale apo në biznes elektronik, bënë gjykime specifike për atë që është e drejtë apo e gabuarë, që do të thotë ajo bënë pretendime se çfarë duhet të bëhet ose çfarë nuk duhet të bëhet. Etika është universale dhe zbatohet për gjdo gjë që ka marrëdhënie me individët. Çështjet etike në biznesin elektronik, janë një problem apo një situatë që kërkon që një person ose organizatë të zgjedhë midis alternativave që duhet të vlersohen si etike dhe jo-etike dhe nuk do të ngarkohen nga autoriteti. Modelet dhe kornizat i'u ofrojnë audiencave një perspektivë të ndryshme dhe globale lidhur me pasojat etike të transaksioneve elektronike, aplikacione të tregtisë elektronike dhe avancimet teknologjike për përdorimin e sigurt në internet.

Zbatimi i tregtisë elektronike përfshinë shumë çështje ligjore. Këto çështje ligjore mund të klasifikohen në disa duke përfshirë tema të tilla si vlefshmeria e kontratave, juridiksioni mbi tregtinë, politikat e enkriptimit etj. Ndërsa nga ana tjetër, merren çështjet etike që konsiderohen të jenë të drejta ose të gabuara. Gjatë viteve fillozofët kanë propozuar shumë udhëzime etike, por ajo që është joetike nuk është domosdosmerisht edhe e paligjshme. Kështu që në shumë raste kur individët ballafaqohen me një vendim etik atëherë ata nuk shqyrtojnë se po shkelin ligjin. Në mjedisin e sotëm kompleks, përkufizimet e së drejtës dhe të gabuarit nuk janë gjithmonë të qarta. Në teori, mund të dallojmë ligjin, çështjet dhe çështjet etike. Nëse bejmë diçka që nuk është e ligjshme atëherë e thyejmë ligjin, por nëse bejmë diçka joetike atëherë nuk mund ta thyejmë ligjin. Natyrisht shumë akte të paligjshme janë gjithashtu joetike. Problemi është se në teknologjinë e informacionit, nuk është gjithmonë e qartë çka është e paligjshme por çështjet etike mund të jenë të diskutueshme.

4. KËRKESA LIGJORE PËR BIZNESIN ELEKTRONIK

Në përgjithësi, të gjitha ligjet ekzistuese që zbatohen në tregtinë tradicionale zbatohen në mënyrë të barabartë në një mjedis elektronik. Këto përfshihen gjërat e tilla si ligjet që rregullojnë themelimin e biznesit, regjistrimin e emrit të biznesit, tatimin, mbrojtjen e konsumatorit, reklamën mashtrore, importimin, eksportimin, sigurinë e produkteve standardet e produkteve, kodin penal, pronsinë intelektuale dhe përgjegjësinë. Biznesi pavarësisht nga madhësia e tij duhet të jetë në përputhje me ligjet e çdo juridiksioni si brenda ashtu edhe jashtë vendi ku konsiderohet se po kryhet një biznes.

Tregtia dhe interneti është duke u rritur me shpejtësi që nga vitet 1990, dhe gati çdo veprimtari me pakicë apo shumicë ka një faqe interneti për shitjen e mallrave të saj. Me anonimitetin e internetit, është shumë vështirë për një blerës të njohë dhe të besojë shitësin. Nëqoftë se përfshihemi në biznesin elektronik, ne fund të marrveshjes duhet ti kemi parasysh disa çështje etike themelore të biznesit:

Nuk është e vështirë për hakerët e kompjuterëve që të kenë qasje në informacione jetësore personale në internet. Shumë konsumatorë kryejnë transaksione duke plotësuar formularë me të dhëna personale, duke përfshirë emrin, mbiemrin, datën e lindjes, adresën fizike, adresën e emailit, dhe numrin e telefonit. Meqenëse nuk mund të përdoret cash online, që të shkruani dhe të dërgoni një kontroll është jopraktik, klientët përdorin kartat e kreditit ata transmetojnë numrat e kartelave, datat e skadimit dhe kodet e sigurisë në internet, ku është e prekshme ndaj vjedhjes. Numri i kartelës së debitit dhe skadimit mund të ofrojnë qasje të drejtëpërdrejtë në një llogari bankare, edhe pse përdoruesi i paautorizuar në shumicën e rasteve do të ketë gjithashtu nevojë për një PIN. Për të shmangur këto çështje faqet e tregtisë elektronike duhet të përdorin softver të përditësuar të sigurisë për të enkriptuar informacionin personal.

5. ÇËSHTJET ETIKE QË LINDIN NGA PËRDORIMI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE NË VENDIN E PUNËS

Posta elektronike është bërë mjeti më i popullarizuar i komunikimit në mjedisin profesional. Komunikimet elektronike, për shkak të natyrës së tyre, përmbajnë një seri të çështjeve etike siç janë: Komunikimet në distancë, komunikimet asinkronike, tekstuale dhe ndërvepruese me kompjuterin që lejojnë ruajtjen, rikthimin, transmetimin dhe manipulimin e mesazheve. Këto veçori shkaktojnë keqkuptime, sjellje të pahijshme në mungesë të bashkëbiseduesve, mbingarkesë të informacionit dhe postë, si dhe shkelje të privatesisë dhe keqpërdorim të burimeve të përbashkta informatike. Format tjera të sjelljes jo etike gjejnë rrenjën e tyre në kulturën e korporatave, konkurrencën e brendshme dhe stilin e menaxhimit. Bizneset elektronike, si dhe teknologjia e informacionit dhe e komunikimit janë veçanërisht të ekspozuara ndaj sjelljeve të tilla, pasi ato mbështeten shumë në komunikimet elektronike. Prandaj ata duhet të vlersojnë situatën e tyre të brendshme dhe të zhvillojnë dhe zbatojnë politikat e postës elektronike në përputhje me rrethanat. Dixhitalizimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK), si dhe zgjerimi në mbarë botën i rrjetave, shërbimeve dhe aplikacioneve të bazuar në TIK, dhe në veçanti internetit dhe World wide web, kanë shtruar rrugën dhe kanë bërë të mundur zhvillimin e nderlidhur në biznesin elektronik. Interneti gjithashtu ka ndryshuar mënyrën se si ne komunikojmë dhe ndërlidhemi, si në jetën private ashtu dhe atë profesionale. Gjatë dekadës së kaluarë, sipas një analize të kryer shihet se posta elektronike (e-maili) është bërë mjeti më popullor i komunikimit në mjedisin profesional, duke tejkaluar telefonin fikse dhe mobile. 96% e

organizatave të hulumtuara deklaruan se ofruan qasje në e-mailin në vendin e punës tek punonjësit e tyre, 91% në një konvercionale telefonike fikse dhe 86% në telefon celular profesional. Për shkak të natyrës specifike të bizneseve elektronike, si dhe adoptuesit e hershëm të TIK-ut, si infrastrukturat bazë dhe mjetet që mbështesin modelet e tyre të biznesit, si dhe tendencat drejtë përdorimit më të madh të komunikimeve kompjuterike të ndërmjësuar dhe në veçanti e-maili është e dukshme në tregtinë elektronike dhe në biznese online. Nuk ka dyshim që komunikimet elektronike kanë futur një ndryshim në metodat e menaxhimit, organizimit të punës, si dhe në ecurinë e biznesit, siç ka në përgjithësi në ekonomi. Ndërkohë që TIK-u ka përmirësuar dukshëm komunikimet biznes-biznes ose biznes-konsumatorë, ato kanë ndikuar ndjeshëm gjithashtu edhe në jetën tonë profesionale dhe personale. Çështjet etike nuk janë specifike për biznesin elektronik në vetvete. Megjithatë, bizneset elektronike kanë karakteristika specifike, sepse modeli i tyre mbështetet shumë në komunikimet elektronike, gjë që i bën ata më të ndjeshëm ndaj disa çështjeve etike e në veçanti për disa sjellje joetike. Perspektiva menaxheriale trajton çështje të tilla si monitorimi i punonjësve, përdorimi privat i burimeve të kompanisë, si dhe zbatimin e ambienteve të favorshme të punës dhe i politikave të brendshme përkatese. Perspektiva e punonjësve përfshin çështje të tilla si privatsia, autonomia dhe mbingarkesa e postës. Së fundi perspektiva ndërpersonale mbulon çështje të tilla si roli i postës elektronike në komunikimet profesionale, respektimi i ndërsjelltë dhe keqkuptimi në komunikim.

6. ANONIMITETI DHE BESIMI

Biznesi elektronik ofron një mundësi për të krijuar tregje që tejkalojnë kufizimet e botës reale në tregje. Megjithatë, transaksionet e biznesit elektronik kanë një nivel të shtuar të mosbesimit që nuk është i pranishëm në transaksionet reale për shkak të anonimitetit të internetit. Tejkallimi i mosbesimit kërkon një qasje etike ndaj problemit të besimit, gjë që do të thotë se pjesëmarrësit mendojnë se duhet të marrin një rrezik edhe kur mashtrimi është një mundësi. Duke këmbëngulur që njerëzit t'i përmbahen parimeve tradicionale etike nuk adresojnë rrënjën e problemit, që është mungesa e kontaktit personal që krijon anonimitetin. Një sjellje sentimentale morale sugjeron një mënyrë për të kapërcyer problemin e motivimit pa sakrifikuar të gjitha përfitimet e shtuara të biznesit elektronik.

7. SHANSET DHE SFIDAT

Edhe pse biznesi elektronik u ofron organizatave një mori shansesh të reja, ai i paraqet, gjithashtu menaxherëve më një seri sfidash. Së pari, shumë modele të reja të biznesit elektronik duhet të provojnë ende burime të mira fitimi. Dixhitalizimi i proceseve për biznesin elektronik kërkon ndryshime organizative të mëdha. Mjedisi ligjor për biznesin elektronik nuk është forcuar ende dhe kompanitë që ndjekin atë duhet të jenë në gaditshmëri për sigurinë.

- **Ndryshime të mëdha organizative.** Biznesi elektronik kërkon orkestrim të kujdesshëm të divizioneve të firmës, të vendndodhjeve të prodhimit dhe të zyrave të shitjeve, si dhe marrëdhëniet e ngushta me klientët furnitorët dhe me partnerët e tjerë tregtarë në rrjetin e krijimit të vlerave. Proceset thelbësore tregtare duhet të riprojektohen dhe të intergrohen më shumë, veçanërisht ato për menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Duke pasur parasysh se menaxhimi i zinxhirit të furnizimit kërkon rreshtimin e praktikave dhe të sjelljeve tregtare të kompanive të ndryshme në zinxhir, atëherë biznesi elektronik kërkon që këto kompani të kenë politika dhe procedura të përcaktuara mirë për ndarjen e të dhënave me pjesëtarët e tjerë të zinxhirit, përfshirë karakteristikat për tipin, formatin, nivelin e saktësisë dhe sigurinë e të dhënave që do të shkëmbehen.
- **Çështjet ligjore.** Ligjet që drejtojnë biznesin elektronik janë ende në krijim e sipër. Legjislacioni, gjykatat dhe marrëveshjet ndërkombëtare sapo kanë nisur të ngrenë pyetje për ligjëshmërinë dhe forcën e kontratave elektronike, për rolin e firmave elektronike dhe për aplikimin e internetit është botëror dhe përdoret nga njërezit dhe organizatat në qindra shtete të ndryshme.
- **Siguria.** Transaksionet e biznesit elektronik përfshirë postën elektronike, kalojnë përmes shumë sistemesh kompjuterike në internet përpara së të arrijnë në destinacion. Ky informacion mund të monitorohet, të kapet dhe të ruhet në secilën nga këto pika gjatë rrugës. Të dhënat e vjera mund të interceptohen dhe të gjurmohen. Të tilla mund të jenë të dhënat personale si dhe plane marketingu, kontratat shitjesh, të dhënat për krijimin e produktit dhe çmimin, negociatat midis kompanive dhe të dhënat e tjera që mund të jenë të çmueshme për konkurrencën.

8. PËRFUNDIM

Ligjet ashtu edhe etika kanë një rolë të madh në biznes, dhe që ato lidhen me njëra tjetrën mirpo me një dallim që ligjet janë rregulla që duhet zbatuar dhe vendosen nga shteti, ndërsa etika ka të bëjë me kontekste të mira apo të këqija dhe ato janë të diskutueshme për shoqërinë. Biznesi elektronik është një element qëndror i tregut bashkohor dhe modelet e biznesit elektronik po vazhdojnë të zhvillohen. Format e ndryshme të biznesit elektronik po ofrojnë mundësi unike për të arritur të konsumatori, këto praktika të tilla gjithashtu ngrejnë çështje me natyrë etike.

Teknologjitë e reja po shtojnë dilema etike të reja. Teknologjitë e reja kompjuterike kanë të bëjnë me mbledhjen, ruajtjen, manipulimin dhe komunikimin e të dhënave që kanë të bëjnë me përhapjen e informacionit dhe të gjitha këto së bashku po krijojnë dilema etike. Etika vendosët për arsye për ta mbrojtur ambientin nga publiku i gjerë dhe për këtë arsye etika duhet të jetë e lidhur me ligjëshmërinë për të ndihmuar në mbrojtjen e parimeve të saja. Nëse ne bejmë marrveshje me biznese të tjera duhet pasur parasysh gjatë nënshkrimit të ndonjë kontrate. Të dhënat e klienteve duhet të mbrohen si ligjrisht ashtu edhe teknikisht për arsye se mund të ndodhin keqpërdorime në të dhënat e konsumatorëve. Siguria e informacionit është një shqetësim i madh qoftë edhe për një biznes të vogël, është përgjegjsi e tregtisë elektronike të mbrojtë informacionet e klienteve. Me anë të kriptimit të informacionit i pengojnë hakerët të qasën në të dhënat personale të konsumatorëve Gjithashtu gjatë shitjes së ndonjë malli apo produkti nuk duhet ta teprojmë me cilësitë e produktit por duhet të jepim informacione të besueshme, sepse konsumatorët mund të jenë të paknaqur dhe mund të përhapet informacioni në rrjetet sociale dhe kështu mund të largohen klientët. Për të pasur përfitime një organizatë duhet të krijojë siguri si dhe ndryshime në organizatë, kjo ka të bëjë në kujdesin e divizioneve, si dhe marrëdhënjet e ngushta me klientët, furnitorët dhe me tregtarët anëmbanë botës.

LITERATURA

- Alexander, L., & Ferzan, K.K. (2016). *Crime and Culpability: A Theory of Criminal Law*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Bierman, G., Smith, K.M., & Risa, A. (2015). *Hyrje ne biznes USA*
- Doucet, M. (2014). "Playing Dice with Morality: Weighted Lotteries and the Number Problem," *Utilitas*,
- France, M. (2014). *The Mea culpa Defense*, BusinessWeek, Boston
- Halstead, J. (2016). "The Numbers Always Count," *Ethics*,
- Huseby, R. (2014). "Spinning the Wheel or Tossing a Coin?" *Utilitas*,
- Moore, M., & Hurd, H.M. (2015). "Blaming the Stupid, Clumsy, Selfish, and Weak: The Culpability of Negligence," *Criminal Law and Philosophy*,
- Palmer, D. (2015). *Ethical Issues in e-business, USA*
- Schaffer, J. (2015). "Disconnection and Responsibility," *Legal Theory*,
- Walen, A., (2016). "Transcending the Means Principle," *Law & Philosophy*,